



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ prot.,

Tiranë më _____.____.2025

V E N D I M

Nr. 6 datë 19.05.2025

PËR

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT
“ANALIZË E TREGUT TË SHËRBIMEVE POSTARE DHE VLERËSIMI I OFRUESVE TË
MUNDSHËM TË SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Gentian	Sala	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
3. Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4. Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5. Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 19 maj 2025, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 15 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr.7, datë 16.2.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar”.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 10 dhe 13, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”;
2. Nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
3. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”;
4. Neni 5, pika 2 i Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 239, datë 02.05.2018, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal”.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor mbi çështjen, si më poshtë:

- a) Dokumentit: “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”;
- b) Relacioni shpjegues i projektaktit;
- c) Projektakti i formatuar,

si dhe referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke arsyetuar në mbështetje të bazës ligjore referuese,

VËREN:

1. AKEP është autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë. Për të përmbushur qëllimin e përcaktuar në nenin 13 të ligjit nr. 46/2015, AKEP ka detyrimin që të përcaktojë ofruesin e shërbimit universal postar, si dhe të mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar. AKEP cakton ofruesin e shërbimit universal postar, në bazë të një procedure konkurrimi, sipas rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, nëse nga analiza e zhvillimit të tregut konstaton që ka, të paktën, dy ofrues të shërbimeve postare që mund të sigurojnë ofrimin e shërbimit universal postar, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
2. Nisur nga ky kontekst ligjor, AKEP duhet të kryejë analizën e tregut postar dhe të vlerësojë numrin e ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar sipas parashikimeve të ligjit nr. 46/2015 dhe VKM nr. 239, datë 2.5.2018 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal”, bazuar në të dhënat statistikore dhe financiare periodike të dërguara nga ofruesit si dhe mbi informacionet e administruara nga procedurat e inspektimeve.
3. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendim nr. 13, datë 30.6.2020, ka pajisur me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal “Posta Shqiptare” sh.a., me afat 5 (pesë) vjeçar. Afati i përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit individual, për ofrimin e shërbimit universal postar, të Posta Shqiptare sh.a., është data 7 korrik 2025. Në përfundim të këtij afati, AKEP duhet të kryejë procesin e rishikimit për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas përcaktimeve të nenit 13 të ligjit nr. 46/2015.

4. Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, përmban një analizë të ecurisë së treguesve të tregut postar në Shqipëri, dhe vlerësimin e kapaciteteve tekniko-ekonomike të ofruesve të shërbimit postar, për të ofruar shërbimin universal postar në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 46/2015 dhe akteve nënligjore të tij. Dokumenti është përgatitur për këshillim publik dhe në Aneksin 1 të tij, janë përfshirë pyetjet për palët e interesuara. Afati i këshillimit publik është 30 ditë nga data e publikimit të dokumentit në faqen zyrtare të AKEP.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikave 1 të nenit 14, dhe 15, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neneve 10 dhe 13 të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

VENDOSI:

1. Të miratojë nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore, duke filluar nga data 19.05. 2025.
3. Vendimi dhe Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*”, të publikohen në faqen e zyrtare të AKEP.
4. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka